

Përmbajtja

1. SUSTCULT në një guaskë
2. Takimi i fillimit të projektit në Venecia (14-15 Prill 2011)
3. Prezantim i shkurtër i 7 siteve të trashëgimisë
4. Të dhënat kyçe të projektit SUSTCULT
5. Prezantim i shkurtër i programit SEE

Arritja e
qëndrueshmërisë
nëpërmjet
një
këndvështrimi
të
integruar
për
menaxhimin
e
trashëgimisë
kulturore .

SUSTCULT

Të dashur lexues . Mirësevini në numrin e parë të letrës informative SUSTCULT.

Nga tani e tutje , pothuajse në çdo gjashtë muaj , kjo letër informative do t'ju mbajë të informuar mbi aktivitetet e projektit dhe rezultatet, iniciativat e lidhura me të , evente të lidhura me trashëgiminë kulturore në zonën e Europës Juglindore dhe më tej . Shijojeni leximin !

1. SUSTCULT në një "guaskë"

Shumë site të trashëgimisë në Rajonin e Europës Juglindore janë nën tryzni. Përmirësimi efektiv i menaxhimit të siteve kulturore është një prioritet dhe një sfidë e madhe kulturore dhe politike në të gjithë rajonin. Këndvështrimi sipas SUSTCULT është që trashëgimia kulturore ka një kuptim të rëndësishëm social dhe ekologjik , i cili do të ruhet si një burim i zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivi kryesor i Projektit SUSTCULT është të përmirësojë efektivitetin e menaxhimit të siteve të trashëgimisë nëpërmjet zhvillimit të një metodologjie të përbashkët të vlerësimit të kompleksitetit të trashëgimisë kulturore në Europën Juglindore.

Aktivitetet kryesore të projektit:

- Ngritja e 7 rrjeteve lokale dhe një rrjeti ndërkombëtar në Europën Juglindore në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore.
- Zhvillimi dhe funksionimi i një platforme EEB GIS për ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë;
- Përcaktimi i një metodologjie të përbashkët ndërkombëtare për menaxhimin e integruar të siteve të trashëgimisë kulturore.
- Hartimi dhe realizimi i një pakete trajnimit (kurse trajnimit online dhe në cdo sit) për të rritur kapacitetin menaxhues.
- Zhvillimi/Përmirësimi i planeve të menaxhimit në site e partnereve bazuar në një metodologji të përbashkët.
- Peërcaktimi i një strategjie marketingu të qëndrueshëm për resurset specifike kulturore bazuar në analizën e tregut lokal dhe planet e biznesit.

Rezultatet e pritura :

Përmirësimi i bashkëpunimit lokal dhe ndërkombëtar nëpërmjet përfshirjes së aktoreve kyc ; rritja e ndergjegjesimit të publikut të gjerë dhe tek aktorët për vlerat e trashëgimisë së Europës Juglindore dhe potencialin e saj në tërheqjen e burimeve financiare dhe rritje të qëndrueshme ; ndarje e eksperiencave dhe të informacionit referuar gjeografisë mbi trashëgiminë kulturore ; kuadër pune mbi menaxhimin e qëndrueshëm të trashëgimisë; kapacitet institucional në rritje në menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë ; rritje të përdorimit të informacionit kompjuterik dhe teknologjisë dhe promovim i burimeve kulturore; menaxhim dhe integrim i përmirësuar i siteve të trashëgimisë kulturore në instrumentat e planifikimit ; të kuptuarit më mirë të mundësive të tregut dhe strategjive për rritjen e atraktivitetit të siteve dhe gjenerimin e të ardhurave.

2. Takimi i fillimit të projektit në Venecia (14-15 Prill 2011)

Hapja zyrtare e projektit SUSTCULT u zhvillua në 14 Prill në Venecia në prestigjiozin Pallatin Dukal në Sheshin San Mark .Prezenca e pothuajse gjithë partnerëve të projektit dhe aktoreve lokalë nga gjithë Rajoni Veneto si dhe të gjitha kontributet e tyre të cmuara , rezultuan në një takim të suksesshem . Eventu u hap nga Zv/Kryetari i Bashkise Venecia për Planifikimin Urban Z. Ezio Micelli, i cili u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe bëri një prezantim të shkurtër të temave kryesore të projektit dhe qëllimet e planifikuara. Më pas, një fjalim shumë interesant nga Renata Codello-Drejtoreshë e Zyrës për Ruajtjen e Trashëgimisë Arkitekturore, Natyrore , Historike , Artistike dhe Etno-Atropologjike në Venecia , u fokusua në problemet kryesore të territorit dhe sfidat.

Për të përfunduar prezantimet e shkurtra nga partnerët vendas, Qyteti i Venecias, menaxherët e Politikave Europiane dhe Ndërkombëtare dhe të Planifikimit Urban, prezantuan strukturat e tyre respektive dhe stafin që punon në menaxhimin e projektit dhe koordinimin shkencor të SUSTCULT. Përfaqësuesit e Komitetit Shkencor paraqitën një pamje të plotë të objektivave të programit dhe të pritshmërive të projektit SUSTCULT: pati shumë ndërhyrje interesante nga partnerët për një zhvillim të suksesshem të projektit në muajt në vazhdim. Më qëllim që të fokusoheshin më tej në çështjet e projektit , skuadra e Venecias prezantoi në detaje partnerët e projektit, objektivat kryesore , aktivitetet, rezultatet e pritura dhe grupet e synuara : ky prezantim paraprak ishte thelbësor për të filluar familjarizimin me strukturën dhe aktorët e projektit.

Gjithashtu Zyra e UNESCO-s ne Venecia , si një partner vëzhgues , mori pjesë në takim duke dhënë shumë kontribute të vyera mbi procedurat e UNESCO-s për hartimin e planeve menaxhuese të siteve të trashëgimisë . Ky prezantim vendosi hapat e parë të kuadrit të nevojshëm për të kuptuar më mirë punën që duhet kryer nga partnerët gjatë jetës së projektit.

Për të përfunduar punën e paradites, të gjithë partnerët bënë një prezantim të shkurtër të organizatës së tyre dhe rolit në projekt : mundësia e parë për të takuar koleget tanë për tre vitet në vazhdim!!

Pasditja e datës 14 si dhe pjesa e paradites së datës 15 iu dedikua projektit dhe procedurave të menaxhimit dhe rregullat e zbatimit të cilat do të diskutohen në partneritet.Komiteti Drejtues i SUSTCULT mori pjesë në datën 15 në një tur me varkë në lagunën veriore të Venecias (përfshirë ishujt San Servolo dhe San Erasmo) të cilët përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të sitit të Unesco-s në Venecia.



3. PREZANTIM I SHKURTER I 7 SITEVE TE TRASHEGIMISE

Itali - "Venecia dhe lagunat e saj"

Sit kulturor .Themeluar në shekullin 5 dhe i përhapur në mbi 118 ishuj të vegjël , Venecia u bë një fuqi detare kryesore në shek. 10 . I gjithë qyteti është një kryevepër e jashtëzakonshme arkitekturore në të cilën edhe ndërtesa më e vogël përmban punë të bëra nga artistët më të medhenj të botes si Giorgione, Titian, Tintoretto, Veronese dhe të tjerë.

Venecia, është një arritje unike artistike. Influenca e Venecias në zhvillimin e arkitektures dhe arteve monumentale ka qenë e konsiderueshme. Venecia përmban një seri të pacmuar të ansambleve arkitekturore që ilustrojnë moshën e shkëlqimit të saj. Ajo prezanton një tipologji të kompletuar ku vlerat ekzemplare shkojnë së bashku me karakterin e famshëm të një mjedisi urban të cilit i është dashur të përshtatet me kërkesat e vecanta të zonës. Venecia rrethohet nga një masë ujore më e pasura ekologjike në Mesdhe :Laguna e Venecias. Laguna është një masë e madhe ujore e vendosur ndërmjet kontinentit dhe detit Adriatik .Është një mjedis unik dhe dëshmi historike e balances delikate me njeriun . Në lagunë peisazhi natyror është ndryshuar në mënyrë konstante nga qeëniet humane , duke e mirëmbajtur habitatin e saj , biodiversitetin dhe proceset dinamike.Republika Serenissima ka ndërhyrë fuqishëm në qytet dhe në lagunë me qëllim të mirëmbajtjes së proceset e zhvillimit dhe ekuilibrit dinamik të ndjeshëm.

Slovenia - Vipava Valley

Peisazh kulturor .Siti përfaqëson një shembull të vyer të aseteve të peisazhit kulturor : lugina rrethohet nga platetë e larta Trnovski Gozd, Hrušica dhe Nanos dhe nga Vipava Hills.Për shekuj,zona ka qenë një rrugë kalimi ndërmjet Italisë dhe Rajonit të Danubit , por mban të paprekur tipare të vecanta natyrore .Lugina mban resurse natyrore me interes të madh dhe monumente të shenjta , kryesisht kisha të periudhës Gotike dhe kështjella që formojnë një peisazh kulturor shumë të vlerësuar. Shembuj të mirë janë Kështjella Kromberk, një fortesë e rinovuar e Rilindjes , prona Bartolomei, një ndërtesë me dy kate me elementë të ruajtur të Barokut të vonë, prona e ruajtur shumë mirë për gjueti Zemono , kështjella e shek.13 Rihemberk,Manastiri Franceskan Kostanjevica dhe fshati i shek.13 Vipavski Križ me muret e kështjellës së tij dhe konventën Capuchin. Të gjitha këto resurse të famshme e bëjnë këtë peisazh kulturor të vlefshëm për t'u ruajtur dhe për t'u përmirësuar më tej nëpërmjet një plani specifik menaxhimi.

Greqi- Korfuz

Sit kulturor . Qyteti i vjeter i Korfuzit , është i vendosur në një pozicion strategjik në hyrje të detit Adriatik dhe i ka rrënjët në shek. 8 p.e.s.

Ansambli urban dhe i portit të Korfuzit përbëjnë një shembull arkitektonik të një vlere të jashtëzakonshme universale si në autenticitetin dhe integritetin e saj. Përveç politikave proaktive të restaurimit , shumë punë akoma kanë filluar dhe po vazhdojnë. Përgjegjësia për ruajtjen e sitit i takon Ministrisë Greke të Kulturës , Bashkisë Korfuz dhe Supermbikëqyrësit për antikitetet Bizantine dhe Post-Bizantine.Siti kulturor është përfshirë në listën e Unesco-s në 2007 , pas paraqitjes së Planit të Menaxhimit të përgatitur nga Bashkia Korfuz dhe aktoret e tjerë të lidhur.

Shqipëria - Berat

Sit kulturor . Qyteti i Beratit, deklaruar Qytet Muze ne 1961 nga Qeveria Shqiptare , iu shtua Listës së Trashëgimisë Kulturore të Unesco-s në 2008, si një shembull i rrallë i një qyteti të periudhës Otomane. I vendosur në Shqipërinë Jugore, Berati është një qendër historike e fortifikuar , i cili dëshmon pasurinë dhe diversitetin e trashëgimisë arkitekturore të rajonit. Berati është vendosur në Lumin Osum, ndërmjet Malit të Tomorrit dhe luginës së Myzeqesë. Siti përbëhet nga tre pjesë : Kalaja e Beratit e ndërtuar mbi një kodër në anën veriore të lumit , lagjia Mangalem vendosur në këmbët e kodrës së kalasë , kalaja e Goricës dhe lagjia e saj vendosur në bregun jugor të lumit .Qendra urbane e qytetit ka dëshmi të jashtëzakonshme të llojeve të ndryshme të monumenteve dhe ndërtesa urbane që i takojnë periudhës Klasike Otomane.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë - Ohri

Siti i përzier kulturor dhe natyror :qyteti i Ohrit është një sit i përzier i Unesco-s dhe një nga vendbanimet më të hershme njerëzore në Europë. Qyteti dhe Rajoni i tij historik dhe kulturor janë të vendosur në një vend natyror të një vlere të vecantë , ndërsa arkitektura e tij përfaqëson ansamblim më të ruajtur dhe më të kompletuar të arkitekturës së hershme urbane në trojet Sllave. Në 1979 qyteti i Ohrit është përfshirë në Listën e Unesco-s në kriterin natyror dhe në 1980 u njoh gjithashtu edhe vlera kulturore e zonës duke e bërë Ohrin një zonë të përzier. Ohri me të vërtetë përmban site shumë të vlerësuar arkeologjike të periudhës Neolitike si dhe site të tjera të periudhës së Bronzit dhe Helenistike ;më shumë se 250 site arkeologjike janë gërmuar. Brenda zemrës së qytetit , shtrihet qyteti i vjeter i Lichnid,me pas i quajtur Ohri,duke u kthyer në një nga qytetet më kryesore të mesjetës në Ballkan.

Rumania : Bakau

Sit kulturor. Bakau është i vendosur në vendbanimet antike që kanë ekzistuar qysh në vitin 4500 p.e.s. Është qendra e rajonit (Kontea Bakau) dhe ka shumë nga monumentet e tij dhe sitet arkeologjike. Kontea është e vendosur në Rajonin Moldova dhe ka një diversitet të madh burimesh :kulturore, historike,natyrore dhe një traditë të rëndësishme dhe të pasur kulturore. Trashëgimia kulturore përfshin : mbetje arkeologjike, kisha, muzeume,shtëpi muze, dhe monumente arkitekture ndërmjet të cilave : kompleksi i Curtea Domneasca, Kishat Precista dhe Sh. Nikolae, shume shtëpi monumente, Parku Dendrological dhe Kështjella Rosu. Territori karakterizohet nga prezenca e shumë fshatrave të vegjël , ku akoma ruhet tradita lokale : Glavanesti, Izvorul Berheciului i njohur për punimet artizanale në dru. Nga ana tjetër, tradita e pasur e artizanatit në Kontenë Bakau,dhe shumë nga fshatrat e saj kanë bërë që këto qytete të mirëpresin evente artistike më të rëndësishme për Rumaninë, duke dhënë prova të prezences së vlerave të larta kulturore.

Rumania: Manastiri i Hurezi-t

Sit kulturor. I formuar në 1690 nga Princi Konstantin Brancoveanu, Manastiri i Hurezi-t , në Ëalachia, është një kryevepër e stilit 'Brankovan'. Është i njohur për pastërtinë dhe balancën arkitekturore , pasurinë e detajeve të tij skulpturore, trajtimin e përbërësve të tij fetarë , portretet e tij dhe punimet dekorative të pikturës.Shkolla e pikturave murale dhe ikonave e ngritur në Manastir në shek.18 u bë e famshme në gjithë rajonin e Ballkanit.

4.Të dhena kyce SUSTCULT

SUSTCULT Arritja e qëndrueshmërisë nëpërmjet një këndvështrimi të integruar për menaxhimin e trashëgimisë kulturore .

Programi : Programi i Europes Juglindore– prioriteti 4

Projekti fillon : 01/01/2011

Kohëzgjatja: 36 months

Buxheti total : Euro 1.707.080,78

Partneri kryesor : Bashkia Venecia

Partneriteti : SUSTCULT përfshin 12 institucione nga 7 vende (Itali, Slloveni, Greqi, Rumanë dhe Hungari,

FYROM dhe Shqipëri) duke formuar një partneritet të mirë-balancuar me lidhje të fortë territoriale. 3 autoritete lokale, 1 autoritet kombëtar, 1 autoritet rajonal, 2 universitete, 2 agjensi zhvillimi, 2 OJF, 1 organizatë derkombëtare (vëzhgues)

5. PREZANTIM I SHKUTËR I PROGRAMIT SEE

TProgrami i Europës Juglindore (SEE) është pjesë e objektivit të Bashkpeunimit Territorial European të Politikës Rajonale të BE .Programi synon përmirësimin e procesit të integritit territorial, ekonomik dhe social në Europën Juglindore , duke kontribuar në kohezionin, stabilitetin, dhe konkurrencën e zonës nëpërmjet zhvillimit të partneriteteve ndërkombëtare dhe aktiviteteve të përbashkëta për çështjet me rëndësi strategjike .Programi SEE 2007 - 2013 është një program ndërkombëtar që bashkon numrin më të madh të shteteve pjesëmarrëse: 16 ne total - www.southeast-europe.net

